



Trajnim për Kurset Themeltare



Kushtet e Përdorimit (Përditësuar më 2021-13-04) Njoftim mbi Privatësinë (Përditësuar më 2021-06-04)

© 2021 by Intellectual Reserve, Inc. All rights reserved.



MIRË SE VINI

Mirë se vini te mësimdhënia e kurseve Themeltare në institut! Faleminderit që e pranuat mundësinë për t'i ndihmuar studentët tuaj që ta thellojnë kthimin e tyre në besimin te Jezu Krishti dhe ungjilli i Tij i rivendosur.

PËRPARA MËSIMDHËNIES


Përpara mësimdhënies, do t'ju duhet:

- Ta shqyrtoni pjesën [Orientues për të Filluar Shpejt](#) për mësimdhënien e Kurseve Themeltare
- Ta studioni me kujdes hyrjen te [Materiali i Mësuesit](#).
- Të caktoni një kohë me bashkërenduesin ose drejtorin tuaj të institutit për të diskutuar mbi detyrën tuaj, studentët, kursin dhe çfarëdo pyetjeje që të keni.
- Të luteni për udhërrëfim që t'i ndihmoni studentët tuaj të vijnë te Krishti dhe të bëhen më shumë si Ai.

OBJEKTIVAT E TRAJNIMIT TË STAFIT TË MËSIMDHËNIES


Ka shumë parime dhe aftësi që janë të rëndësishme për mësimdhënien e efektshme. Mund të vazhdoni t'i studioni parimet dhe t'i ushtroni aftësitë që jepen mësim në manualin e seminarit dhe institutit. Për qëllimet e këtij trajnimi të stafit të mësimdhënies, disa aftësi kyç të lidhura me mësimdhënien e kurseve Themeltare

në institut do të përkufizohen, do të jepet modeli [për to] dhe do të ushtrohen për t'ju ndihmuar të orientoheni me kursin dhe programin mësimor. Këto aftësi mund t'ju ndihmojnë të siguroni një përvojë lartësuese dhe kthimi në besim për studentët ndërsa kërkon t'i ndihmoni ata të Përgatiten, të Angazhohen dhe të Veprojnë për t'i ndihmuar të bëhen si Shpëtimtari Jezu Krisht.




- **Përgatituni:** Rriteni Përgatitjen e Studentëve Nëpërmjet Ftesës
- **Angazhohuni:** Angazhohini Studentët duke u Mbështetur te Përgatitja e Tyre
- **Veproni:** Theksojeni Vënien në Zbatim

Rriteni Përgatitjen e Studentëve Nëpërmjet Ftesës



AFTËSIA: Rriteni Përgatitjen e Studentëve Nëpërmjet Ftesës

Si do ta rritni përgatitjen e studentëve tuaj për ta përmirësuar përvojën e tyre në orën mësimore?



Lexojini këto pjesë dhe ndiqni udhëzimet. Mbajeni shënim në tabelën e diskutimit atë që po mësoni.



PËRKUFIZONI

Në kurset Themeltare, Materiali i Përgatitjes për Orën Mësimore ka për qëllim të studiohet si nga ju, ashtu edhe studentët tuaj gjatë përgatitjes për orën mësimore. Materiali i përgatitjes përmban ftesa për ta rritur përgatitjen e studentëve dhe mësuesve nëpërmjet pyetjeve dhe veprimtarive të synuara për të ndihmuar të thellohet nxënia në klasë dhe jashtë saj. Secila prej këtyre ftesave shoqërohet nga ikona për t'ju ndihmuar të shihni mënyrën dhe kohën se kur përdoren këto ftesa dhe si mund të mbështeteni te këto në orën mësimore.



JEPNI MODELIN

Ja tek janë disa shembuj të këtyre ftesave për përgatitje që mund t'i gjeni te programi mësimor:



Përsiatni në Përgatitje për Orën Mësimore

Shembull: “Çfarë përvojash ju kanë ndihmuar të dini se Libri i Mormonit është fjala e Perëndisë?”



Studioni gjatë Përgatitjes për Orën Mësimore

Shembull: “Profeti Alma i dha mësim popullit rreth Shlyerjes së Shpëtimtarit. Lexoni tek Alma 7:11–13.”



Mbajini Shënim Mendimet Tuaja

Shembull: “Në ditarin tuaj ose në hapësirën e dhënë, shkruani disa të vërteta që ju bëjnë përshtypje nga fragmentet e shkrimeve të shenjta dhe nga mësimet në këtë pjesë, si edhe ndonjë mendim dhe pyetje tjetër që keni. Ejani në klasë të përgatitur për të treguar të vërtetat që i përcaktuat dhe ndonjë ide.”



Diskutoni Gjatë Përgatitjes për Orën Mësimore

Shembull: “Me ndihmën e një pjesëtari të familjes ose një miku, përcaktoni disa vënie aktuale në zbatim të parimeve që zbuluat nga këto vargje. Ejani në klasë gati për të treguar atë që mësuat.”



Veproni Sipas Asaj që Keni Mësuar

Shembull: “Çfarë do të bëni në ditët dhe javët e ardhshme për t’u shërbyer të tjerëve si Jezu Krishti?”

Tani që e keni parë se si programi mësimor e rrit përgatitjen e studentëve nëpërmjet ftesës, ushtrohuni për t’i kërkuar dhe përdorur këto ftesa në programin mësimor.



USHTROHUNI

Plotësojini hapat vijues që të ushtroheni për t’i kërkuar dhe përdorur këto ftesa për ta rritur përgatitjen e studentit.

1. Shkoni te një mësim në materialin e përgatitjes për orën mësimore për kursin që po jepni ose do të jepni mësim, dhe hidhuni një sy ftesave të paraqitura për përgatitje.
2. Përzgjidheni njëren nga këto ftesa.
3. Merreni parasysh se si mund të duket bërja e kësaj veprimtarie gjatë përgatitjes së një studenti. Mendoni rreth ndikimit që mund të ketë kjo ftesë për përgatitje te përvoja e studentit përpara dhe gjatë orës mësimore. Mendoni rreth mënyrës se si mund t’i ftoni studentët të përgatiten për orën mësimore të ardhshme duke i ndihmuar ata t’i përcaktojnë këto ftesa për përgatitje.
4. Përcaktoni një ftesë tjetër për përgatitje dhe përsëriteni këtë ushtrim.

Familjarizimi dhe efektshmëria në përdorimin e ftesave për përgatitje do t’ju ndihmojnë të përqendroheni te studentët dhe ta rritni përgatitjen e tyre për të pasur një përvojë më të thellë të të nxënit.



INTEGROHUNI

Ndërsa punoni për ta rritur përgatitjen e studentëve nëpërmjet ftesës, merrini parasysh pyetjet në vijim:

- Si do t'i integroni ato që mësuat nga këto ushtrime, ndërsa jepni mësim?
- Çfarë mund të bëni për ta vazhduar ushtrimin e kësaj aftësie që të mund të përmirësoheni si mësues?



DISKUTONI


Mbajeni shënim në tabelën e mëposhtme të diskutimit atë që keni mësuar nga kjo përvojë. Sigurohuni që ta lexoni atë që kanë shkruar të tjerët, për të parë atë që po mësojnë dhe bëjnë ata.

Angazhojini Studentët duke u Mbështetur te Përgatitja e Tyre



AFTËSIA: ANGAZHONINI STUDENTËT DUKE U MBËSHTETUR TE PËRGATITJA E TYRE

Si do t'i angazhoni studentët tuaj duke u mbështetur tek ajo që ata kanë studiuar, mësuar dhe ndier gjatë përgatitjes së tyre për orën mësimore?



Lexojini këto pjesë dhe ndiqni udhëzimet. Mbajeni shënim në tabelën e diskutimit atë që po mësoni.



PËRKUFIZONI

Gjatë gjithë kursit Themeltar, programi mësimor mund t'ju ndihmojë të mirëbesoni dhe të mbështeteni te përgatitja e studentëve. Materiali i mësuesit përfshin shumë shtysa për angazhim për t'i ftuar studentët të "shqyrtojnë", "të kujtojnë", "të gjejnë veten", "të tregojnë nga përgatitja e tyre" e kështu me radhë për t'ju kujtuar dhe nxitur që të përdorni të kuptuarit dhe përgatitjen e studentëve për ta drejtuar përvojën në klasë.



JEPNI MODELIN

Ja tek janë disa shembuj të këtyre shtysave për angazhim që mund t'i gjeni te programi mësimor:

- "Ftojini studentët të tregojnë nga përgatitja e tyre për orën mësimore atë që mbajnë mend rreth kësaj situate".
- "Kujtojuni studentëve se në materialin e përgatitjes, ata u ftuan për t'i shenjuar të vërtetat që iu bënë më shumë përshtypje. Jepuni studentëve pak kohë që të rishikojnë fragmentet e shkrimeve të shenjta dhe mësimet profetike që i shenjua në këtë pjesë. Kërkojuni atyre t'ia tregojnë klasës atë që mësuuan."
- "Lejojini studentët të diskutojnë për pak minuta në grupe të vogla për mënyrën se si do ta përdornin atë që mësuuan në përgatitjen e tyre për ta ndihmuar mikun/en e tyre".

Tani që e keni parë se si ju ndihmon programi mësimor që të mbështeteni te përgatitja e studentëve, ushtrohuni për kërkimin e këtyre shtysave për angazhim në programin mësimor.



USHTROHUNI

Plotësojini hapat vijues që të ushtroheni për t'i kërkuar dhe përdorur këto lloje shtysash për angazhim që të mbështeteni te përgatitja e studentëve.

1. Shkoni te një mësim në materialin e mësuesit për kursin që po jepni ose do të jepni mësim, dhe hidhuni një sy shtysave të paraqitura për angazhim.
2. Përzgjidheni njëren nga këto shtysa.
3. Merreni parasysh se si mund të duket bërja e kësaj veprimtarie në klasë. Mendoni rreth ndikimit që mund të ketë përdorimi i kësaj shtyse për angazhim te përvoja e studentit.
4. Përcaktoni një shtysë tjetër për angazhim dhe përsëriteni këtë ushtrim.

Familjarizimi me shtysat për angazhim dhe efektshmëria në përdorimin e tyre, do t'ju ndihmojnë të përqendrohni te studentët dhe t'i angazhoni ata në një përvojë më të thellë të të nxënit.



Ndërsa punoni për ta rritur angazhimin në klasë duke u mbështetur te përgatitja e studentëve, merrini parasysh pyetjet në vijim:

- Si do t'i integroni ato që mësuat nga këto ushtrime, ndërsa jepni mësim?
- Çfarë mund të bëni për ta vazhduar ushtrimin e kësaj aftësie që të mund të përmirësoheni si mësues?




Mbajeni shënim në tabelën e mëposhtme të diskutimit atë që keni mësuar nga kjo përvojë. Sigurohuni që ta lexoni atë që kanë shkruar të tjerët, për të parë atë që po mësojnë dhe bëjnë ata.

Theksojeni Vënien në Zbatim



AFTËSIA: THEKSOJENI VËNIEN NË ZBATIM

Si do ta theksoni vënien në zbatim në orën tuaj mësimore? Çfarë do të bëni për t'i nxitur studentët tuaj që të veprojnë sipas asaj që kanë mësuar?



Lexojini këto pjesë dhe ndiqni udhëzimet. Mbajeni shënim në tabelën e diskutimit atë që po mësoni.



PËRKUFIZONI

Përgatitja e efektshme e studentëve dhe e mësuesve përpara orës mësimore, mund të lejojë të keni më tepër kohë në orën mësimore për t'i ndihmuar studentët që të përcaktojnë mënyrat se si t'i jetojnë të vërtetat që identifikojnë në mësim. Materiali i mësuesit është hartuar për të mbështetur përgatitjen e studentit dhe për të ndihmuar në rritjen e fuqisë dhe zotësisë së studentëve për të vepruar në një mënyrë që do t'i ndihmojë ata të bëhen më shumë si Ati Qiellor dhe Jezu Krishti.



JEPNI MODELIN

Ja tek janë disa shembuj të diskutimeve të bazuara te vënia në zbatim, dhe ftesave që mund t'i gjeni te programi mësimor i kursit Themeltar:

- “Bëjuni studentëve pyetjet vijuese: Cilat janë disa nga mënyrat se si ju dhe familja juaj keni marrë pjesë në shërbimin për historinë familjare dhe në tempull? Çfarë bekimesh keni përjetuar për bërjen e kësaj pune? Ju mund t'i ftoni studentët të mendojnë për dikë që mund ta pyesin për t'i këshilluar që të bëjnë historinë familjare. Nëse disa studentë janë tashmë të aftë ta bëjnë historinë familjare, ftojini të këshillojnë dikë tjetër në klasë.”
- “Jepuni studentëve pak kohë që të reflektojnë dhe t'i mbajnë shënim mendimet e tyre rreth pyetjes vijuese: Në çfarë mënyrash mund të jem më aktiv në Kishë dhe të ndihmoj për t'i përmbushur qëllimet e saj?”
- “Paraqiteni pyetjen vijuese: Çfarë do të bëj për ta ftuar fuqinë e Jezu Krishtit më plotësisht në jetën time? Jepuni studentëve kohë që me lutje ta përsiatin këtë pyetje dhe të shkruajnë një përgjigje në ditarët ose fletoret e tyre. Teksa ata po përsiatin, merreni parasysh të paraqitni një citim nga një profet i ditëve të mëvonshme që t'i nxitni ata në mënyra të posaçme për ta ftuar fuqinë e Shpëtimtarit në jetën e tyre.”

Tani që e keni parë se si ju ndihmon programi mësimor për ta theksuar vënien në zbatim nga studentët, ushtrohuni duke përdorur veprimtaritë e mësimdhënies në programin mësimor.



USHTROHUNI

Plotësojini hapat vijues që të ushtroheni për kërkimin dhe përdorimin e veprimtarive të mësimdhënies për ta theksuar vënien në zbatim nga studentët.

- Shkoni te një mësim në materialin e mësuesit për kursin që po jepni ose do të jepni mësim, dhe hidhuni një sy veprimtarive të paraqitura të mësimdhënies.
- Zgjidhni njërën nga këto veprimtari të mësimdhënies dhe lexoni më me kujdes nëpër veprimtarinë dhe pyetjet e lidhura me vënien në zbatim.
- Merreni parasysh ndikimin që mund të ketë kjo veprimtari e mësimdhënies ose pyetjet e bëra te përvoja e studentit.
- Përsëriteni këtë ushtrim duke zgjedhur një mësim tjetër në materialin e mësuesit dhe duke përcaktuar veprimtari të mësimdhënies që ndihmojnë për ta theksuar vënien në zbatim.

Familjarizimi me diskutimet e bazuara te vënia në zbatim dhe efektshmëria në përdorimin e tyre, do t'ju ndihmojnë të përqendroheni te studentët dhe mund t'i ndihmojnë ata të bëhen më shumë si Ati Qiellor dhe Jezu Krishti.



INTEGROHUNI

Teksa punoni për t'i nxitur studentët dhe për të theksuar vënien në zbatim, merrini parasysh pyetjet në vijim. Mbajini shënim mendimet tuaja në tabelën e mëposhtme të diskutimit.

- Si do t'i integroni ato që mësuat nga këto ushtrime, ndërsa jepni mësim?
- Çfarë mund të bëni për ta vazhduar ushtrimin e kësaj aftësie që të mund të përmirësoheni si mësues?



DISKUTONI

Mbajeni shënim në tabelën e mëposhtme të diskutimit atë që keni mësuar nga kjo përvojë. Sigurohuni që ta lexoni atë që kanë shkruar të tjerët, për të parë atë që po mësojnë dhe bëjnë ata.

Përmbledhje

PËRMBLEDHJE

Faleminderit sërish që e pranuat mundësinë për t'i ndihmuar studentët tuaj që ta thellojnë kthimin e tyre në besimin te Jezu Krishti dhe ungjilli i Tij i rivendosur.

MBAJENI MEND:

- Zoti do t'ju udhërrëfejë ndërsa kërkon t'i ndihmoni studentët tuaj që të vijnë te Krishti dhe të bëhen më shumë si Ai.
- Bashkërenduesi ose drejtori juaj i institutit mund t'ju ndihmojë për çfarëdo pyetje ose shqetësimi që të keni.
- Aftësitë që u përkufizuan, për të cilat u dha modeli dhe u ushtruan në këtë trajnim, mund t'ju ndihmojnë të jeni më të efektshëm në vënien në përdorim të programit mësimor për t'i bekuar studentët tuaj. Këto aftësi mund t'ju ndihmojnë të siguronit një përvojë lartësuese dhe kthimi në besim për studentët ndërsa kërkon t'i ndihmoni ata të Përgatiten, të Angazhohen dhe të Veprojnë për t'i ndihmuar të bëhen si Shpëtimtari Jezu Krisht.

